

VENDIM
Nr. 64/2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
90/2017 “PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Deputetët Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Eugen Bojaxhiu dhe Koçi Tahiri caktohen anëtarë në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

2. Deputeti Eljo Hyskaj caktohet anëtar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe në Komisionin për Politikën e Jashtme.

3. Deputeti Ardit Konomi caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

4. Deputeti Vasil Sterjovski caktohet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme.

5. Deputetja Amra Barova largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

6. Deputetja Ediola Braha largohet nga Komisioni për Integrimin Evropian dhe caktohet anëtare në komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

7. Deputetja Edlira Hyseni largohet nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe caktohet anëtare në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

8. Deputeti Arben Elezi largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet anëtar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

9. Deputetët Klajdi Qama dhe Kostaq Papa caktohen anëtarë në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

10. Deputetja Suzana Topi caktohet anëtare në Komisionin për Integrimin Evropian.

11. Deputetët Kujtim Gjuzi dhe Halit Valteri caktohen anëtarë në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

12. Deputetja Artemis Dralo (Malo) caktohet anëtare në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 23.5.2019.